



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec



Zyra për Informim



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljenje za Opštu Upravu

Nr. I prot. 2134 Më 01.07.2020
Br. prot. RAHOVEC - ORAHOVAC

Raporti i punës së zyrës për Informim Janar-Qershor 2020

-Zyra për informim funksionon në kuadër të zyrës së kryetarit të komunës, kjo zyrë punën e saj mbështet në statutin e komunës, rregulloren komunale për transparencë dhe planin komunal për transparencë për vitet 2019-2023.

Si rezultat i respektimit të dokumenteve të lartë përmendura, janë publikuar dokumente të cilët janë përgatitur nga kryetari i komunës, drejtorët e drejtorive komunale dhe zyra e kuvendit komunal. Gjithashtu, janë publikuar në uebfaqen zyrtare të komunës, vendime, rregullore, plane, raporte, dokumente të tjera, dokumente të përgatitura nga OJQ-të e ndryshme. Publikimi i këtyre dokumenteve, ka ndikuar në rritjen e performancës dhe llogaridhënies në komunën e Rahovecit.

Pas caktuar nga ana e kryetarit të komunës, si zyrtar përgjegjës për menaxhimin me Platformën e Konsultimeve Publike dhe koordinimin e zbatimit të standardeve minimale të konsultimit publik në komunë, për herë të parë janë publikuar në Platformën e Konsultimeve Publike, dokumentet të cilat duhet të kalojnë në konsultim-debate me qytetarë.

-Lajmet, njoftimet dhe dokumentet tjera që kanë të bëjnë me zyrën e kryetarit, kryesuesit dhe drejtorive komunale, janë publikuar në uebfaqe dhe të njëjtat janë dërguar për publikim në portalet lokale gjithashtu edhe në ato nacionale, bashkëpunimi me media në përgjithësi është i mirë dhe se nuk kam pasur ndonjë vërejtje.

-Komuna e Rahovecit nga KDI, është renditur e para në mesin e 38 komunave të Republikës së Kosovës për transparencë, kjo është arritur falë punës që është bërë nga shumë zyrtar komunal, punë e mirë në rritjen e transparencës është duke u bërë në vazhdimësi.


- Nga kryetari i komunës me vendim jam caktuar Zyrtar përgjegjës për menaxhimin e platformës së konsultimeve publike dhe koordinim për zbatimin e standardeve minimal të konsultimeve publike në komunën e Rahovecit, me të marrë vendimin në uebfaqe të komunës është krijuar një vegëlz për këtë platformë dhe që është aktive dhe qytetarët mund të hynë dhe të shohin dokumentet e komunës të cilat janë në konsultim-debat publik.
- Gjatë kësaj periudhe raportuese kam përgatitur planin për dokumentet komunale që do të kalojnë procedurat e debateve dhe konsultimeve publike, i njëjti është publikuar në uebfaqen zyrtare të komunës.
- Gjatë muajit Maj-Qershor jam marrë me plotësimin e dokumenteve të cilat kanë pasur të bëjnë me Performancën Komunale për vitin 2019.
- Kamë bërë plotësimin e dokumentit i cili ka të bëjë me “Indeksi i Transparencës në qeverisjen komunale **2019**”, këto të dhëna janë kërkuar nga Instituti Demokratik i Kosovës dhe se plotësimi i këtij dokumenti ndikon në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies për Komunën e Rahovecit
- Kam përgatitur regjistri për evidencën kërkesave të pranura dhe përgjigjeve të dhëna për Qasje në Dokumentet Publike të Komunës së Rahovecit duke u bazuar në ligin për QDP Nr. 06L-081, në fund të vitit apo nëse kërkohet nga institucionet që na monitorojnë publikimi i këtij regjistri me të gjitha detajet do të publikoj në uebfaqe të komunës, por që ky dokument sigurisht që do të publikohet në fund të vitit 2020, në dokument i tillë është duke u bërë për herë të parë, pasi që në të kaluarën është publikuar raporti vjetor për QDP me informata të shkurtera.
- Kam përgatitur 3 raporte për 3 debate-konsultime publike që janë mbajtur me qytetarë, OJQ dhe grupe të interesit.
- Gjatë kësaj periudhe raportuese në dokumentin me listën e dokumenteve të publikuara në uebfaqen zyrtare të komunës janë publikuara gjithsej 124 dokumente, ky dokument është përgatitur si rezultat i problemeve të kohëpaskohshme që po ka uebfaqja zyrtare e komunës, publikimi i këtij dokumenti do të publikohet në fund të vitit 2020.
- Edhe gjatë kësaj periudhe raportuese, bashkëpunimi me media lokale dhe ato nacionale ka qenë i mirë dhe se sa herë që kanë kërkuar të dhëna, u jam përgjigjur me kohë dhe rrjedhimisht nuk kam pasur asnjë problem.

Më poshtë në tabelë mund ti shihni të dhënat e publikuara për muajt Janar-Qershor si: Lajme, Njoftime, Ftesa, Thirrje, Vendime, Konkurse, Ankande, Debate dhe Qasje në Dokumente Publike.

Muajt	Lajme	Njoftime	Ftesa	Thirrje	Vendime	Konkurse	Ankande	Debate	QDP	Nr i përgjithshëm i aktiviteteve
1.Janar	24	10	0	1	19	1	0	1	2	58
2.Shkurt	17	5	0	0	21	6	0	1	0	50
3.Mars	44	21	0	1	9	0	0	0	1	76
4.Prill	50	17	0	0	16	1	0	0	0	84
5.Maj	24	5	0	2	49	1	0	1	1	83
6.Qershor	14	10	1	4	131	1	1	3	0	156

Vërejtje:

Si pasoj e pandemisë COVID-19, nuk janë përgatitur njoftimet lidhur me mbajtjen e tubimeve përkujtimore.

Haziz Krasniqi

 Zyrtar për Informim